

Vendim nr. 178 datë 16.09.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimimi, anëtarë, në datën 16.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (K) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **KËSHILLI I MINISTRAVE**, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, Besmir Beja dhe Irma Qosja, me autorizim.

OBJEKTI: **Plotësimi i vendimit nr. 52, datë 27.06.2024 të Gjykatës Kushtetuese.**

BAZA LIGJORE: **Neni 80 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datat 18.06.2024 dhe 25.06.2024 Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) ka marrë në shqyrtim çështjen me kërkesues jo më pak se një të pestën e deputetëve të Kuvendit, shoqatat “Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar” dhe “Instituti i Kontabilistëve të Miratuar”, si dhe Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë dhe me subjekte të interesuara Kuvendin e Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave, me objekt kontrollin e kushtetutshmërisë së disa dispozitave të ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar (*Ligji i Tatimeve*) dhe të vendimit nr. 753, datë 20.12.2023 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar” (*VKM nr. 753/2023*).

2. Në përfundim të shqyrtimit, me vendimin nr. 52, datë 27.06.2024 (vendimi nr. 52/2024), Gjykata ka vendosur: “Pranimin e pjesshëm të kërkesës. Shfuqizimin e nenit 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë, të ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Shfuqizimin e nenit 4 të vendimit nr. 753, datë 20.12.2023 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, si të papajtueshëm me Kushtetutën. Rrëzimin e kërtimeve të tjera.”. Ky vendim është shpallur në datën 31.07.2024 dhe është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 136, datë 05.08.2024.

3. Pas publikimit të vendimit dhe njoftimit të tij palëve, Këshilli i Ministrave (kërkuesi), i cili ka pasur cilësinë e subjektit të interesuar në atë gjykim, i është drejtuar Gjykatës me kërkesën e datës 10.09.2024 për plotësimin e mangësisë në vendimin e saj për t’u shprehur për efektet e tij, sikurse parashikon neni 76, pika 3, i ligjit nr. 8577/2000. Sipas kërkuesit, vendimi është i paqartë në lidhje me efektet ndaj pasojave që kanë sjellë dispozitat ligjore dhe nënligjore të shfuqizuara.

4. Kolegji i Gjykatës në datën 13.09.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi** ka pretenduar se në vendimin nr. 52/2024 të Gjykatës konstatohet mungesa e disponimeve mbi efektet e tij ndaj pasojave të ardhurave nga zbatimi i Ligjit të Tatimeve dhe VKM-ja nr. 753/2023. Sipas kërkuesit, këto akte kanë sjellë pasoja dhe efekte me shtrirje të gjatë kohore dhe kur vendimi ka hyrë në fuqi një pjesë e efekteve të tyre tashmë ishin prodhuar, ndërsa një pjesë tjetër jo. Në kushtet kur është e qartë se bazuar në nenin 76, pika 7, shkronja “c”, të ligjit nr. 8577/2000, efektet e tjera të parashikuara nuk mund të vijnë më, mbetet e paqartë situata se çfarë do të bëhet me efektet dhe pasojat e ardhura. Konkretisht, sipas kërkuesit, deri në datën 28.06.2024 numri i subjekteve të shërbimeve profesionale që kanë qarkulluar të ardhura deri në 14 milionë lekë dhe kanë shlyer këstet e parapaguara është 6,541, ndërsa vlera totale e tyre është 501,325,388 lekë. Për këtë pjesë kërkuesi është i paqartë se çfarë efekti sjell vendimi nr. 52/2024. Sipas tij, në çdo rast Gjykata duhet të shprehet për efektet e saj, gjë e cila në rastin konkret nuk rezulton të ketë ndodhur.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

6. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se edhe pse kërkuesi në objektin e kërkesës ka kërkuar plotësimin e vendimit nr. 52/2024 të Gjykatës dhe në bazën ligjore ka referuar nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000, në përmbajtje të saj, ndonëse parashtron faktin se mungesa e shprehjes për efektet e tij përbën “një mangësi – të metë” të vendimit, në thelb, ka kërkuar interpretimin e këtij vendimi ndaj pasojave tashmë të prodhuara nga zbatimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore të shfuqizuara pas kontrollit kushtetues të tyre. Kështu, sipas kërkuetit, ai është i paqartë se çfarë efekti sjell vendimi i Gjykatës ndaj pasojave që tashmë Ligji i Tatimeve dhe VKM-ja nr. 753/2023 kanë sjellë për shkak të mbledhjes së kësteve të parapaguara të tatimit mbi të ardhurat deri në 14 milionë lekë nga subjektet që furnizojnë shërbime profesionale. Thënë ndryshe, për kërkuetin është e paqartë se çfarë duhet të bëjë me vlerën prej 501,325,388 lekësh të mbledhur nga administrata tatimore, duke kërkuar në këtë mënyrë plotësimin e vendimit për këtë pjesë të veprimeve të kryera.

7. Paraprakisht, Mbledhja e Gjyqtarëve vë në dukje se nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehin qartësisht për forcën detyruese dhe natyrën përfundimtare të vendimeve të Gjykatës. Po kështu, nenet 72, pika 7 dhe 76, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë se vendimet e kësaj Gjykate kanë fuqi detyruese të përgjithshme, janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Efekti detyrues i këtyre vendimeve ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në këtë pikëpamje, Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë ajo (*shih vendimet nr. 55, datë 10.07.2024; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 44, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, ligji nr. 8577/2000, në nenin 80, pika 1, të tij, ka rregulluar kompetencën e Gjykatës për të saktësuar dhe plotësuar vendimin e saj. Kështu, Gjykata ka të drejtë, me kërkesë, të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në vendim, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. Kjo dispozitë është konkretizuar edhe në përmbajtjen e nenit 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në të cilën përcaktohet se vendimi i Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose Gjykatës pas votimit nuk mund të ndryshohet, por veçse mund të saktësohet, plotësohet ose ndreqen gabime në shkrim ose ndonjë pasaktësi e dukshme e lejuar në të.

8. Në analizë të përmbajtjes së argumenteve të kërkuetit, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se për sa u takon efekteve që vendimi i Gjykatës sjell ndaj pasojave të dispozitave ligjore dhe nënligjore të shfuqizuara, neni 132, pika 2, i Kushtetutës parashikon se vendimet e Gjykatës hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare dhe se Gjykata mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka

shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër. Kurse sipas nenit 26, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 8577/2000, vendimet, si rregull, hyjnë në fuqi ditën e publikimit, përveçse kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj dhe Gjykata mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër.

9. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se Gjykata në vendimin nr. 52/2024, ndërsa ka vendosur shfuqizimin e një pjese të dispozitave ligjore dhe nënligjore të kundërshtuara, duke dhënë edhe argumentet përkatëse për antikushtetutshmërinë e tyre, është shprehur edhe për efektet e vendimit në dispozitivin e tij përmes rregullit të përgjithshëm, sipas të cilit vendimi është përfundimtar dhe hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk gjendet në asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni 80, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000, për rrjedhojë kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të nenit 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.